



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.196/2019

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Afijete Sada Gllogjani kryesuese, Adnan Konushevci dhe Kymete Kicaj anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Vlerona Maliqi, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Partia Liberale Egjiptiane (PLE), me seli në Gjakovë, paraqitur kundër subjektit politik Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës (IRDK), me seli në Pejë, për shkak të nxitjes së urrejtjes, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 06 tetor 2019, në seancën e panelit të mbajtur më datë 05.10.2019, mori këtë:

#### V E N D I M

**REFUZOHET** e pabazuar ankesa Anr.196/2019 e datës 02.10.2019, e paraqitur nga Partia Liberale Egjiptiane (PLE), me seli në Gjakovë, kundër subjektit politik Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës (IRDK), me seli në Pejë, për shkak të nxitjes së urrejtjes gjatë fushatës zgjedhore.

#### A r s y e t i m

Subjekti politik Partia Liberale Egjiptiane (PLE), me seli në Gjakovë, më datë 02.10.2019, ka paraqitur ankesë në PZAP, kundër subjektit politik Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës (IRDK), me seli në Pejë, me të cilën pretendon se me datë 01.10.2019, në një emision në RTK-së, në të cilin ishin të ftuar, kryetari i PLE-së, Veton Berisha, Artan Berisha nga PLE, në përballje televizive me kundërshtarët e subjektit politik IRDK, Elbert Krasniqi – kryetar i IRDK-së dhe Fridon Lala nga radhët e po këtij subjekti politik, gjatë debatit televiziv, E.Krasniqi, ka ofenduar rëndë A.Berisha, duke iu drejtuar me fjalët “Qeni i Sharrit”, dhe ka reaguuar duke buzëqeshur, veprim ky i cili sipas tyre bie në kundërshtim me nenin 33 par.1 të LZP-së. Më tej ka shtuar, se një gjuhë e tillë ofenduese është përdorë nga subjekti politike edhe në të kaluarën, duke u shprehur me terma të ndryshëm si “katundar”, “injorant”, dhe vazhdon të përdoret edhe sot, duke iu referuar vendimit të PZAP-it, Anr.149/2019 të datës 02.10.2019. Paraqitësi i ankesës, si provë, ankesës i ka bashkangjitur një fotografi të printuar në cilësi të provës materiale.

Subjekti politik, Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës (IRDK), në përgjigje në ankesë të datës 03.10.2019, thekson se pretendimet e paraqitësit të ankesës janë të pabazuara, për faktin se në emisionin në fjalë në mesin e të ftuarve nuk ishte edhe paraqitësi i ankesës, duke kërkuar nga PZAP-i, që ankesa në fjalë e cila nuk mbështetet në asnjë bazë dhe në asnjë provë materiale, të hidhet poshtë.

**Ankesa është e pabazuar, për këto arsye:**

Paneli, vlerëson se pretendimet e paraqitësit të ankesës janë të pabazuara, për faktin se paraqitësi i ankesës nuk ka arritur të argumentojë pretendimet e veta, se nga ana e subjektit politik Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës (IRDK), janë bërë veprime, të cilat kualifikohen si shkelje të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP) dhe të Rregullave Zgjedhore.

Paneli, vendimin e tij e mbështet në dëshmi të qarta dhe bindëse siç përcaktohet me nenin 117 par.3 të LZP-së, prandaj pretendimet e paraqitura në ankesë, lidhur me përdorimin e gjuhës ofenduese në kundërshtim me dispozitën e nenit 33 par.1 të LZP-së, nga ana e subjektit politik Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës (IRDK), Paneli i vlerësoi si të pabazuara për faktin se paraqitësi i ankesës nuk ka arritur që të argumentojë me prova bindëse pretendimet e tij, nuk është shënuar se në cilin emision televiziv ka ndodhur ajo çfarë ai ka cek. Paraqitësi i ankesës, në ankesë thirret se shkelja ka ndodhë në një emision televiziv duke ofruar si provë vetëm një fotografi të printuar, në cilësi të provës materiale, e cila nuk argumenton pretendimet e paraqitësit të ankesës për përdorim të gjuhës ofenduese nga subjekti politik IRDK ndaj subjektit politik PLE.

Nga arsyet e theksuara më lartë, e duke u bazuar në nenin 115 par.1 dhe nenin 118 par.1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
Anr.196/2019 më datën 05.10.2019

**Kryesuese e Panelit**  
Afijete Sada Gllogjani



***Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së.***